

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale, ndaj të akuzuarit R. J., nga Prishtina rruga “ H. Z.” nr.numri..., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.7527/16 të dt. 21.04.2017, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.10.04.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores M. L., dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

R. J., nga i ati E., me nr. personal *numri personal...*, i lindur me dt.21.03.1954 në Rahovec, tani me banim në Prishtinë, rruga H. Z.” nr.numri..., i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 10.12.2016, rreth orës 12:10, në magjistralen Ferizaj-Prishtine, në fshatin Llugaj, i pandehuri Ridvan Jusufi, deri sa ka qenë duke e drejtuar automjetin e tipit "Daimler- Chrycler me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, në atë menyre që ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 par. dhe nenin 65 par 1, te ligjit për rregullat e trafikut rrugor, ashtu që duke mos e pershtatë shpejtësinë e lëvizjes në raport me kushtet dhe rrethanat e rrugës, gjatë perball kalimit nuk e ka mbajtur distancën e sigurisë anësore në mes mjetit të ti dhe mjetit tjetër në trafik dhe duke perballë kaluar ka dal në shiritin tjetër të lëvizjes dhe e ka godit me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit të tij në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin-kombin e tipit "Citroen” me ngjyrë të bardhë, me targa te regjistrimit *numri i targës...*, të cilin e drejtonte i dëmtuari Skender Sadiku, i cili ishte duke levizur ne shiritin e vet qarkullues nga Prishtina në drejtim të Ferizajt, me ç'rast të dëmtuarit, S. S. i shkakton lendime te lehta trupore, si dhe dëm material në automjet,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform të dispozitave të lartcekura dhe dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 46, 73, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së , dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e gjykon:

M E D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumë prej 150.-€, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konfrom nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, do të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari S. S. nga Prishtina rruga “V. F.” nr.numri..., udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt gjyqësore.

DETYROHET: i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizen mjeko ligjore të paguaj shumen prej 20-€, për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumen prej 40.88-€, për paushallin gjyqësor shumën prej 20-€, si dhe për

kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30-€, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.7527/16 të dt. 21.04.2017, e ka akuzuar të pandehurin R. J., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor përfaqësuesja e Prokurorisë ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore, me vullnet dhe pa presion, e në përputhje dhe me provat dhe shkresat të cilat janë bashkangjitur lëndës, andaj edhe i propozon gjykatës që pranimin e fajësisë ta pranojë dhe njëherit ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor, pasi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, deklaroi se e ndjen vetën fajtor për veprën penale që i vihet në barrë dhe njëherit shton se ditën kritike ka qenë i penguar nga dielli për çka ka bërë kjo të dalë në rrugë dikun 25 cm dhe komunikacioni ka qenë shumë i dendur, është në moshë 64 vjeqare andaj, gjitha këto kanë bërë të vie deri tek aksidenti, por i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jet më i kujdesshëm në komunikacion dhe i propozon gjykatës që t'i shqiptoi një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e të pandehurit para kryerjes se vepres penale, pra faktin se asnjeher me parë nuk ka ra ndesh me ligjin, sjelljen pas kryerjes se vepres penale ku i njejt ka shpreh keqardhje per ate qe i ka ndodhur, premtimin e se do të jet më i kujdesshëm, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjt i shqiptoi, dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK, ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u murr në bazë të nenit 39 par. 1 pika 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u murr në bazë të nenit 463 të KPPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 345/17 dt. 10.04.2018

Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjt. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.